



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 01.03.2017

Vendim
Nr. 31, datë 01.03.2017

PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN E
PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK

Në mbështetje të nenit 66 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 01.03.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat dhe procedurat për punësimin e personelit ndihmësakademik si më poshtë:
 - a. Në rast të një vendi vakant për personel ndihmës akademik, njësia bazë/njësia kryesore/njësi tjetër në nivel institucional, së cilës personeli i shërben, përgatit kërkesën për shpalljen e konkursit publik duke përcaktuar kriteret që duhet të kenë kandidatët e interesuar sipas përshkrimit të vendit të punës.
 - b. Kërkesa për shpalljen e konkursit për punësim i përcillet rektorit përmes drejtuesit të njësisë kryesore përkatëse/drejtuesit të njësisë tjetër në nivel institucional. Në rast se rektori nuk miraton kriteret ose kualifikimet e kërkuara për vendin vakant, kërkesa i përcillet njësisë përkatëse për t’u rishqyrtuar.
 - c. Me miratimin e kërkesës për konkurs publik, Rektori përmes Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit e përcjell për botim njoftimin e konkursit publik në Web-in e institucionit. Njoftimi publikohet edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Afati që u lihet kandidatëve për të aplikuar është 14 ditë nga publikimi i njoftimit në Web-in e institucionit.
 - d. Rektori me urdhër ngre një komision *ad hoc* për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant për:
 - personelin ndihmësakademik që do të punësohet pranë njësisë kryesore me 5 anëtarë, i përbërë nga:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Dekani i Fakultetit, i cili kryeson Komisionin, nga tre anëtarë, pjesë e personelit të njësisë kryesore përkatëse, dhe Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit.

- personelin ndihmësakademik që do të punësohet pranë njësisë bazë apo me 5 anëtarë, i përbërë nga:

Përgjegjësi i Njësisë Bazë, i cili kryeson Komisionin, nga tre anëtarë, pjesë e personelit të njësisë bazë përkatëse, dhe Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit.

- personelin ndihmësakademik që do të punësohet pranë njësive të tjera në nivel institucional me 5 anëtarë, i përbërë nga:

Drejtuuesi i njësisë i cili kryeson komisionin, tre anëtarë, pjesë e personelit të kësaj njësie dhe Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit.

- e. Skema e vlerësimit hartohet me vendim të Komisionit *ad hoc* dhe miratohet nga Rektori.
- f. Vlerësimi i mësipërm kryhet nga çdo anëtar i Komisionit *ad hoc* për secilin kandidat. Në përfundim mblidhen pikët e dhëna nga anëtarët e Komisionit për të njëjtin kandidat dhe hartohet klasifikimi paraprak.
- g. Pas vlerësimit paraprak kryhet intervista me kandidatët e klasifikuar, të cilët njoftohen për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës në numrin personal dhe në adresën e Email-it të deklaruar prej tyre nga Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit.
- h. Komisioni i intervistës përbëhet nga Rektori, Kryetari dhe anëtarët e Komisionit *ad hoc*. Komisioni vëzhgon performancën e komunikimit të kandidatëve dhe i vlerëson ata me pikë sipas sistemit të pikëzimit të vendosur nga Komisioni *ad hoc*.
- i. Dokumenti i intervistës i përcillet sërish Komisionit *ad hoc*, i cili i shton vlerësimit paraprak edhe pikët e intervistës. Kandidatët që nuk respektojnë orarin e fillimit të intervistës apo nuk paraqiten fare, skualifikohen nga gara.
- j. Sektori i Burimeve Njerëzore bën njoftimin e kandidatëve fitues dhe atyre që nuk përzgjidhen (jo fitues).
- k. Kandidatët jo fitues kanë të drejtën e ankimit tek Rektori brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit të komisionit.
- l. Rënditja përfundimtare e kandidatëve i përcillet Rektorit pas mbarimit të afatit të ankimit, i cili shpall fitues kandidatin e renditur i pari me të cilin lidh kontratën e përgatitur nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK**

2. Ky vendim të pasqyrohet në Rregulloren e Universitetit “Ismael Qemali” Vlorë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.